

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl. – Kzz. Nr. 03/2011

10 maj 2011

Prishtinë

## NË EMËR TË POPULLIT


Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Lars Dahlstedt si Kryetar i kolegjit dhe gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta, Marije Ademi dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit.

Të asistuar nga Zyrtari ligjor i EULEX-it Sampsa Hakala si procesmbajtës,

Në procedurën penale kundër **Bekim Zekës**, i lindur më \_\_\_\_\_, emri i babait \_\_\_\_\_, emri i nënës \_\_\_\_\_ me mbiemër të vajzërisë \_\_\_\_\_, vendlindja \_\_\_\_\_, komuna \_\_\_\_\_, ka të kryer \_\_\_\_\_, me gjendje \_\_\_\_\_, në paraburgim \_\_\_\_\_;

I shpallur fajtor me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën Ap.-Kž. Nr. 365/2009, të datës 20 korrik 2010 për veprën penale të Vrasjes së kryer në bashkëpunim për përfitim personal sipas Nenit 30, par. 2, pikës 3 të Ligjit Penal të Kosovës, të vitit 1977 (LPK), lidhur me Nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së) dhe i dënuar me njëzet (20) vjet burgim.

Duke vendosur rreth kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë Pkl. – Kzz. 03/2011, të paraqitur më 5 tetor 2010 nga i pandehuri Bekim Zeka kundër aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, P.nr 268/2008, të datës 1 korrik 2009, dhe të aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.-Kž. Nr. 365/2009, të datës 20 korrik 2010.



Pas dërgimit të një kopjeje të kërkesës në Zyrën e Prokurorit Shtetëror të Kosovës (ZPShK),

Pas seancës së mbajtur më 10 maj 2011,

Duke vepruar sipas Neneve 454 dhe 456 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nxjerr këtë

### **AKTGJYKIM**

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur më 5 tetor 2010 nga i pandehuri Bekim Zeka kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës P. Nr. 268/2008, të datës 1 korrik 2009 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.-Kž. Nr. 365/2009, të datës 20 korrik 2010 REFUZOHET si e pabazë.**

### **ARSYETIM**

#### **I Historia procedurale**

Akuza kundër Bekim Zekës ka të bëjë me vrasjen e E B , një taksist nga Peja, në datë të panjohur diku në fund të muajit qershor 1999.

Më 29 korrik 2008, është nisur hetimi penal kundër Bekim Zekës dhe një të pandehuri tjetër. Me aktakuzën PP. nr. 259/2008, të datës 17 tetor 2008 të paraqitur nga Prokurori publik i qarkut të Pejës, Bekim Zeka dhe një i bashkëpandehur në fund janë akuzuar për veprën penale të Vrasjes së kryer në bashkëpunim, për përfitim personal sipas Nenit 30, par. 2, pikës 3 të LPK-së.



Më 8 prill 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka vendosur të caktojë këtë lëndë për kolegjin e përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor.

Shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Qarkut të Pejës është mbajtur në mes të datës 15 qershor dhe 1 korrik 2009. Më 1 korrik 2009, të dy të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprën penale të Vrasjes së E B , të kryer në bashkëpunim për përfitim personal. Bekim Zeka është dënuar me njëzet (20) vjet burgim. Ai po ashtu është ndëshkuar me pagesën e shumës prej dhjetëmijë (10,000.00) eurosh për palën e dëmtuar Sh B , si kompensim fillestar.


Mbrojtësi Abit Asllani si përfaqësues i Bekim Zekës ka paraqitur një ankesë kundër aktgjyqimit të shkallës së parë. Kjo ankesë është refuzuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës me aktgjykimin e datës 20 korrik 2010 (Ap. – Kz. 365/2009).

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar të pandehurit më 10 shtator 2010. Më 5 tetor 2010, i pandehuri Bekim Zeka ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, P. Nr. 268/2008, të datës 1 korrik 2009 dhe aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.-Kž. Nr. 365/2009, të datës 20 korrik 2010.

Sipas Nenit 454, par. 2 të KPPK-së, kjo kërkesë i është dërguar ZPShK-së për të dëgjuar mendimin e saj. Më 21 janar ZPShK-ja ka kthyer shkresat e lëndës në Gjykatën Supreme pa dhënë fare mendimin apo propozimin e saj.

## **II Çështjet e ngritura në këtë Kërkesë**

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë Bekim Zeka pohon se në aktgjykimin e kundërshtuar AP. Nr. 268/2008, përkatësisht Ap. Kz. 365/2009) të Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjendja faktike është konstatuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë, përderisa Bekim Zeka këmbëngul se nuk është fajtor për



vrasjen e E B . Sipas kësaj kërkesë, nuk janë marrë parasysh faktet vendimtare dhe se provat e paraqitura nuk janë vlerësuar si duhet. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, i pandehuri pretendon se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë gabuar në gjatë vlerësimit të përmbajtjes së dëshmive të dëshmitarit. Në veçanti, i pandehuri kundërshton besueshmërinë e dëshmisë së dhënë nga dëshmitarja T H .


### III Gjetjet e Gjykatës Supreme

Sipas Nenit 454 dhe 26, par. 3 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës është gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Kolegji është formuar në përputhje me Nenin 3.7 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë, Ligjit Nr. 03/L-53.

Gjykata Supreme konstaton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur brenda afatit të përcaktuar me ligj si dhe nga personi i autorizuar për të bërë një gjë të tillë.

Për më tepër, Gjykata Supreme konstaton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazë. Sipas Nenit 451, par. 2 i KPPK-së: *“Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.”*

Siç shihet më lart, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga i pandehuri kundërshton ekskluzivisht vetëm gjendjen faktike të konstatuar me aktgjykimet e kundërshtuara të Gjykatës së Qarkut të Pejës (AP. Nr. 268/2008) dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap. – Kz. 365/2009). Gjykata Supreme konstaton se sipas Nenit 451, par. 2 të KPPK-së një kërkesë e tillë për mbrojtjen e ligjshmërisë për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk mund të ushtrohet. Nëse kërkesa është




ushtruar mbi këtë bazë, Gjykata Supreme, në përputhje me Nenin 456 të KPPK-së do ta refuzojë atë si të pabazë.

Megjithëkëtë, Gjykata Supreme do të vazhdojë më tej me vlerësimin nëse arsyetimi që lidhet me faktet materiale është dhënë në aktgjykimet e kundërshtuara në përputhje me rregullat e procedurës penale, të cilat përcaktojnë që gjykatat duhet të japin në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të provuara dhe të paprovuara si dhe arsyetimin për këtë (Neni 387, par. 2 dhe 397, par. 9 i KPPK-së). Gjykatat, po ashtu, posaçërisht bëjnë vlerësimin e besueshmërisë së provave kundërtënëse. Mospërmbushja e kushteve që dalin nga këto dispozita mund të rezultojë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale po qe se një lëshim i tillë nga gjykata ka pasur ndikim ose ka mundur të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt.

Në lëndën në fjalë, Gjykata Supreme konstaton se vlerësimi i provave është bërë nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë në përputhje me kushtet ligjore dhe në mënyrë të kujdesshme, transparente dhe bindëse. Është bërë vlerësimi i provave shfajësuese dhe i atyre fajësuese si dhe nuk është përjashtuar asnjë provë materiale nga shqyrtimi gjyqësor. Gjykatat në mënyrë të qartë kanë deklaruar se cilat pohime faktike i kanë konsideruar si të provuara dhe cilat jo. Kjo gjë shpie tek konstatimi se Gjykata Supreme nuk ka gjetur asnjë shkelje të ligjit në këtë pjesë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pala e dëmtuar Sh \_\_\_\_\_, nuk ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, të datës 1 korrik 2009, P. Nr. 268/2008, dhe kjo nuk është përmendur në aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të datës 20 korrik 2010, Ap.-Kž. Nr. 365/2009. Për shkak të lëshimit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk i është dërguar palës së dëmtuar për përgjigje (Neni 454, par. 2 i KPPK-së). Megjithëkëtë, në lëndën në fjalë dhe veçanërisht përkitazi me arsyet e përmendura nga i pandehuri në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, një përgjigje nga pala e dëmtuar do të kishte qenë jomeritore.

Për këto arsye të përmendura më sipër, është vendosur si në dispozitiv.



**Sot më datën 10 maj 2011.**

**Pkl. – Kzz. Nr. 03/2011**

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë të autorizuar.

**Kryetari i Kolegjit:**

Lars Dahlstedt

**Anëtari i kolegjit:**

Gerrit Marc Sprenger

**Anëtari i kolegjit:**


Nesrin Lushta

**Anëtari i kolegjit:**

Marije Ademi

**Anëtari i kolegjit:**

Salih Toplica



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik